



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 403, datë 30.06.2021**

**“PËR**

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME, KRITEREVE DHE  
PROCEDURAVE SPECIFIKE PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE DHE  
LIDHJEN E KONTRATAVE TË VEÇANTA ME BASHKËPUNETORË TË JASHTËM  
OSE FIGURA TË NJOHURA SHQIPTARE NË DIASPORË, TË CILAT NEVOJITEN  
TË KRYHEN ME QËLLIM ZBATIMIN DHE REALIZIMIN E PROGRAMIT VJETOR  
TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE QË NUK RREGULLOHEN NGA  
LEGJISLACIONI NË FUQI PËR PROKURIMIN PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10/1 të Ligjit Nr.115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe procedurave specifike për realizimin e aktiviteteve që realizon Agjencia Kombëtare e Diasporës, për:
  - a) marrjen me qira të ambienteve;
  - b) kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë;
  - c) veprimtari që zhvillohen jashtë Republikës së Shqipërisë.
  
2. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3 të ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) “**Aktivitete/evente**” organizime si: takime, konferenca, veprimtari kulturore, artistike, që organizohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës mbështetur në planin e veprimit të përcaktuar në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.



b) **“Bashkëpunëtorë të jashtëm”** ata persona fizikë që angazhohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për shkak të cilësive të veçanta që disponojnë dhe për zbatimin e veprimtarive sipas kontratave të lidhura me parë me ta.

c) **“Figura të njohura të diasporës”** personalitete të spikatura të diasporës në fusha të ndryshme që japin kontribute të konsiderueshme për vendin e origjinës.

3. Objekti i konkurrimit dhe kriteret që zbatohen për procedurën e konkurrimit.

a) Agjencia Kombëtare e Diasporës përgatit dhe dërgon ftesat për pjesëmarrje në aktivitetet personave fizikë apo juridikë. Objekti i konkurrimit përmban:

- i. përshkrimin e aktivitetit;
- ii. kriteret e pjesëmarrjes në aktivitet;
- iii. afatin kohor të paraqitjes së ofertave.

b) Kriteret për marrjen me qira të ambienteve janë, si më poshtë vijon:

- i. Ambienti të ofrojë kushte optimale për realizimin e aktivitetit dhe të sigurojë hapësirë e nevojshme për pjesëmarrësit;
- ii. Ambienti të jetë lehtësisht i aksesueshëm.

c) Kriteret që duhet të plotësojnë bashkëpunëtorët e jashtëm/figura të njohura të diasporës janë, si më poshtë vijon::

- i. Të kenë marrë pjesë në aktivitete të mëparshme;
- ii. Të kenë dhënë kontribut për vendin e origjinës;
- iii. T`u jenë akorduar çmime kombëtare apo ndërkombëtare;
- iv. Të ketë ekspertizë në fushën për të cilën zhvillohet aktiviteti.

4. Procedura e përzgjedhjes

a) Komisioni i posaçëm, përgjegjës për zbatimin e procedurës së konkurimit ngrihet me urdhër të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe kryen këto detyra:

- i. Harton kriteret që duhet të përmbushë oferta;
- ii. Përgatit dhe dërgon ftesat për pjesëmarrje;
- iii. Në datën e caktuar shqyrton ofertat dhe përzgjedh ofertën ekonomike më cilësore, me çmimin më të ulët;
- iv. Ankesat për procedurën e konkurimit bëhen pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe shqyrtohen nga një komision i posaçëm, i ngarkuar më urdhër të titullarit të Agjencisë, i ndryshëm nga komisioni i përzgjedhjes së ofertave. Agjencia përgjigjet mbi shqyrtimin e ankesës brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e saj dhe njofton pa vonesa ankimuesin.



- v. Pas përfundimit të procedurës, Agjencia Kombëtare e Diasporës njofton subjektin fitues;
- vi. Procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe arkivohen në strukturat përgjegjëse për arkivimin në Agjenci.
- vii. Raporti përfundimtar miratohet nga titullari institucionit.

b) Titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja e fituesit lidh:

- i. kontratë qiraje sipas modelit shtojca I, pjesë integrale e këtij vendimi;
- ii. kontratë me bashkëpunorët e jashtëm sipas modelit shtojca II, pjesë integrale e këtij vendimi.

5. Aktivitete të Agjencisë Kombëtare të Diasporës që zhvillohen jashtë vendit

- a) Për aktivitetet që zhvillohen jashtë vendit, në rastin e kontratave të qirasë, vlera përcaktohet sipas monedhës së përdorur në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti, konvertuar sipas kursit të këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- b) Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e aktiviteteve jashtë vendit vepron bazuar në rregullat e përcaktuara në këtë vendim si dhe në kontrata të lidhura ndërmjet palëve sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2, pjesë integrale të këtij vendimi.

6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETITIT  
PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**